

KDU 94 (496.51) "1910"

Ardita HAJDARI**ROLI I ISA BOLETINIT NË KRYENGRITJEN E
VITIT 1910 NË KOSOVË**

Isa Boletini ishte njëri ndër udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte figura qendrore e Kryengritjeve në Kosovë gjatë viteve 1910-1912 që luftoi për bashkimin e forcave shqiptare kundër pushtesve osmanë. Për veprimtarin e Isa Boletinit është shkruar dhe shkruhet edhe sot nga studiues të ndryshëm, si tanët ashtu edhe të huajt, të cilët e analizojnë nga shumë këndvështrime personalitetin e tij¹. Isa u lind në Boletin të Shalës së Bajgores më 15 janar të vitit 1864 në një familje të njohur e cila shquhej për tradita atdhetare në rrethinën e Mitrovicës dhe në Vilajetin e Kosovës². Isa Boletini ishte ndër të parët udhëheqës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i cili kishte dalë hapur kundër politikës antishqiptare që bënin turqit e rinj³ të cilët nuk i kishin mbajtur premtimet që ju kishin dhënë shqiptarëve para se të vinin në pushtet. Nga ana tjetër kjo periudhë ishte koha e vlimeve dhe e përpjekjeve të pareshtura të rilindësve dhe të popullit tonë në përgjithësi për çlirim nga Perandoria Osmane⁴. Kohë më parë me shpalljen e Hyrjetit në vitin 1908 Qeveria osmane kishte ndërmarrë një sërë masash dhe ligjesh kufizuese të cilat cenonin të drejtat e popullit shqiptar. Programi kishte të bënte me: ndalimin për mbajtjen e armëve, ligjin mbi rekrutimin e përgjithshëm, vendosjen e taksave të reja, ligjin kundër veprimtarisë së klubeve kombëtare, kundër alfabetit kombëtar dhe gjuhës shqipe. Të gjitha këto çuan në thellimin e kontradiktave midis popullit shqiptar dhe rritën pakënaqësinë e masave popullore në krahina të ndryshme⁵. Lajmi mbi koncesionin e hekurudhës së Mitrovicës, si edhe marrëveshja anglo-ruse për reformat në Maqedoni, kishin krijuar në Kosovë një situatë edhe më të ndërlikuar. Shpërthimi i revolucionit në këto rrethana përkoj me rritjen e lëvizjes së popullsisë shqiptare kundër sundimit osman që arriti kulmin e saj në korrik të vitit 1908⁶, me thirrjen e Kuvendit

1 Dr. Tahir Abdyl. *Tribuni popullor i bashkëjetesës*. Instituti i Historisë - Prishtinë. Prishtinë. Revista "Kosova", Nr. 15, 1986, f. 4.

2 Dr. Fehmi Rexhepi. *Isa Boletini dhe koha e tij*, botuar në Isa Boletini dhe koha e tij. Prishtinë. 1998. f. 12.

3 Fatmira Musaj. *Isa Boletini*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë. 2004. f. 60.

4 Dr. Fehmi Rexhepi. *punim i cit...* f. 13.

5 Prof. Dr. Fatmira Musaj. *Kontributi i Isa Boletinit në organizimin dhe drejtimin e kryengritjes së vitit 1910*, në Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë. Instituti i Historisë - Prishtinë. Prishtinë. 2012. f. 99.

6 Grup autorësh. *Historia e Popullit Shqiptar II (Rilindja Kombëtare Shqiptare – vitet 30' të shek. XIX – 1912)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë. Toena. Tiranë. 2002. f. 375.

të Ferizajt⁷. Ky Kuvend, si edhe lëvizja shqiptare e qershorit-korrikut të vitit 1908, u zhvilluan për shkaqe të ndryshme nga ato të turqve të rinj dhe pikërisht për shkak të rrezikut të aneksimit të territoreve shqiptare, përmes të cilave do të kalonte vija hekurudhore austriake. Qëndresa e armatosur filloi në rrethet e Mitrovicës qysh në prill-maj të vitit 1908 dhe vijoi më pas me tubimet e protestat e shqiptarëve në Prizren, në Prishtinë e në tërë Vilajetin e Kosovës. Në shpërthimin e zemërimit popullor ndikoi edhe lajmi i përhapur, sipas të cilit Porta e Lartë kishte ndërmend t'u shiste austriakëve tokat rreth Ferizajt për ndërtime dhe për vendosjen e kolonëve⁸. Mirëpo, Lëvizja Kombëtare në ditët e para të vitit 1909 doli para Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha me një program kërkesash (ishin kërkesa për autonomi) për të cilat shkruante si shtypi shqiptar ashtu edhe ai i huaj. Kërkesat për autonomi nxitën edhe më shumë reagimet antishqiptare të administratës osmane. Porta e Lartë kishte sjellë forca ushtarake me qëllim që ta shtypë lëvizjen shqiptare në Lumë, në rrethinën e Pejës, në Dibër dhe ta zënë Isa Boletinin. Turqit e rinj duke kuptuar hovin që lëvizja shqiptare kishte marrë për të realizuar kërkesat për autonomi, ndërmorën masa me qëllim të arrestimit dhe burgosjes së krerëve dalluar të Lëvizjes Kombëtare⁹. Në këto rrethana kontradiktat e popullit shqiptar me pushtetin osman, u acaruan edhe më shumë. Pakënaqësia dhe qëndresa popullore në krahina të ndryshme të vendit e sidomos në Kosovë, u rrit dhe mori forma dhe dimensione të gjera¹⁰. Duke parë rrethanat e krijuara, Isa Boletini dhe atdhetarë të tjerë kosovarë organizuan një kryengritje të re të përgjithshme, kundër turqve të rinj me kërkesë kryesore, autonominë e Shqipërisë¹¹. Lajmi për kryengritjen shqiptare nën udhëheqjen e Isa Boletinit u përhap shumë shpejtë jo vetëm në Vilajetin e Kosovës dhe vilajetet tjera shqiptare, mirëpo për lëvizjet kryengritëse shqiptare raportonin edhe konsujt dhe përfaqësuesit tjerë diplomatik. Kështu, në një raport të konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, dërguar ministrit të Jashtëm Berchtold, njoftohej lidhur me përgatitjet për një kryengritje kundër osmane në Vilajetin Kosovës, ku thuhet se veprimtaria e Isa Boletinit që shkon drejtë një revolucioni, energjia e papërkulshme dhe heroizmi i tij, që po i nxjerrin aq shumë telashe regjimit të ri, e afrojnë më tepër mundësinë e një kryengritje¹² me përmasa më të gjëra. Shqiptarët u ngritën në luftë të

7 Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës – Arkivi Shtetëror i Kosovës - Prishtinë, Fondi: Sadulla Brestovci, Nr i inventarit 2, më tej ASHKP.

8 *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 375.

9 Dr. Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 148-149.

10 Fatmira Musaj, *Isa Boletini, vep. e cit.*, f. 73.

11 Po aty, f. 74.

12 Ferit Duka, Dritan Egro, Sokol Gjermani, *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi II, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë – Tiranë, Tiranë, 2012, f. 157.

armatosur kundër një politike reaksionare që ndiqte Qeveria osmane¹³. Pasi kryengritja filloi të marrë hov, Qeveria osmane shpalli shtetrrethim në viset e Kosovës dhe kërkoi nga popullsia t'i dorëzojë armët. Kështu, Këshilli ministror, pas shqyrtimit të situatës, vendosi të dërgojë një ekspeditë ndëshkimore kundër shqiptarëve. Qeveria osmane për komandant të ekspeditës caktoi Shefqet Turgut Pashën, për t'i nënshtruar shqiptarët dhe që ta shtyp kryengritjen¹⁴. Kryengritja e Kosovës përfshiu Rrafshin e Dukagjinit dhe pastaj gjithë Kosovën. Kryengritësit i qëndruan me trimëri sulmeve të ushtrisë turke dhe për disa ditë nuk e lëshuan Grykën e Kaçanikut, mirëpo për shkak të epërsisë numerike dhe teknike të ushtrisë turke kryengritësit u detyruan të tërhiqen nga Gryka e Kaçanikut drejt Moravës së Epërme. Mirëpo, tërheqja ishte e përkohshme sepse kryengritësit vazhduan luftën duke zhvilluar luftime të përgjakshme në fshatrat Kabash, Binçë, Lubishtë, Smirë etj¹⁵. Udhëheqësi kryesorë i forcave kryengritëse ishte Idriz Seferi i cili kishte kontakte të vazhdueshme me Isa Boletinin dhe persona tjerë autoritativ në Vilajetin e Kosovës. Veprimet e Qeverisë osmane për ta shtypur kryengritjen e përkrahnin Austro-Hungaria dhe Rusia, të cilat, meqenëse kishin qëllime të kundërta, ishin të interesuara të mos lejojnë zhvillimin e lëvizjeve kombëtare në Gadishullin Ballkanik, me qëllim që të ruhet status quo në këto vise. Edhe shtetet ballkanike si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia ishin të interesuara që kryengritja shqiptare të shtyhet¹⁶. Qeveria serbe mori në dorë kontrollin e kreditimit të tregtisë serbe në punktet më të rëndësishme të Vilajetit të Kosovës dhe të Manastirit. Zhvillimi i marrëdhënieve tregtare me Perandorinë Osmane kishte për Serbinë rëndësi të madhe ekonomike ngase pjesa dërmuese e eksportit të saj shkonte përmes territorit turk në Selanik. Për këtë arsye Qeveria serbe ishte shumë e interesuar për zgjerimin e koncesioneve për hekurudhën e Adriatikut konventën e re tregtare, duke llogaritur se në këtë kuadër do të siguronte koncesionet për hekurudhën e Adriatikut¹⁷. Kështu gjatë muajit gusht 1909 Kosovën përsëri e përfshinë turbullirat. Ferizaji, Peja, Prizreni dhe Luma ishin bërë qendra rezistence. Me ngarkesat e taksave mbi popullsinë fshatare, përpjekjet e tyre pengoheshin në çdo hap dhe kështu këta faktorë ndikuan që Kosova të mbetet edhe në këto kushte të regjimit të ri qendër e lëvizjeve për çlirim dhe emancipim kombëtar¹⁸. Në fund të vitit 1909 Isa Boletini ripërtëriu lidhjet e krijuara me disa nga krerët e krahinave të ndryshme, me të cilët u

13 Dr. Shukri Rahimi, *vep e cit.*, f. 161.

14 Po aty, f. 162.

15 Po aty, f. 163-164.

16 Po aty, f. 165.

17 Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Prishtinë, 1979, f. 136.

18 Dr. Shukri Rahimi, *vep. e cit.*, f. 153.

mor vesh për të organizuar një kuvend në Verrat e Llukës. Bashkëpunimi i Isa Boletinit me krerët lokal të Rrafshit të Dukagjinit ndikoi në shtimin e vazhdueshëm të forcave Kryengritëse Shqiptare. Midis forcave ushtarake osmane dhe forcave kryengritëse shqiptare u zhvilluan beteja të përgjakshme si ajo e Grykës së Kaçanikut, e Grykës së Carralevës etj¹⁹. Vendimi për të filluar kryengritjen në Kosovë u mor në dhjetor të vitit 1909 në një mbledhje e cila u mbajt në rrethinat e Shkupit. Aty morën pjesë udhëheqësit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare nga Vilajeti i Kosovës si: Isa Boletini, Idriz Seferi, Sylejman Batusha, Shaban Kopriva, Hasan Ferri, Hasan Hysen Budakova, Ramadan Zaskoci etj²⁰. Krahas kësaj për të siguruar një mbështetje sa më të gjerë, ai dhe krerë të tjerë të Malësisë së Gjakovës, Pejës, të Deçanit vendos që te Verrat e Llukës të ftoheshin për marrin pjesë edhe përfaqësues të krahinave të tjera, për të lidhur besën për luftë kundër turqve të rinj dhe për të shprehur qëllimet e kryengritjes. Kuvendi te Verrat e Llukës pati rëndësi të madhe për zhvillimin e lëvizjes së armatosur dhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ngase këtu u manifestua qartë bashkimi i të gjitha krahinave shqiptare, ku lidhën besën për luftë kundër qeverisë së turqve të rinj²¹. Në përputhje me vendimet e miratuara në Kuvendet e Isniqit dhe të Verrat e Llukës delegatët organizuan grupe kryengritësisht. Kështu, flaka e kryengritjes përfshiu të gjitha viset perëndimore e qendrore të Kosovës, rrethinat e Pejës me Rugovë, Prekorupen, Podrimë, Rekën, Malësinë e Gjakovës, Hasin dhe gjithë Drenicën²². Kreator i këtyre organizimeve ishte Isa Boletini i cili bashkë me krerë lokal të zonës, shumë prej të cilëve i kishte kushëri të fisit barten peshën e organizimit. Pranvera e vitit 1910 shqiptarët kosovarë i kishte gjetur të organizuar në grupe të armatosura kundër turqve të rinj²³. Në ditët e para të prillit të vitit 1910 lindën konflikte të armatosura në rrethin e Pejës dhe në Llap, afër Prishtinës midis shqiptarëve dhe ushtrisë që kishte shkuar me dhunë t'i mbledhë taksat. Ky konflikt shërbeu si sinjal për fillimin e kryengritjes së armatosur në mbarë Kosovën. Sipas shembullit të Pejës dhe të Llapit edhe shqiptarët e kazave të tjerë filluan kryengritjen. Qendër kryesore në Rrafshin e Dukagjinit ishte bërë Juniku. Numri i kryengritësve rritej dhe sipas shënimeve të konsujve kishte arritur deri në 15.000, që ishin grumbulluar në mes të Prishtinës, Babin Most dhe

19 Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga Historia Moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë 2011, f.32.

20 Prof. Dr. Frashër Demaj, *Qëndrimi i Fuqive të mëdha ndaj Kryengritjes së vitit 1910*, në *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, Institut i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2012, f. 23.

21 Fatmira Musaj, *Isa Boletini...*, f. 75.

22 Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, *Kryengritja antiosmane e vitit 1910 në Kosovë*, në *Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë*, Institut i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2012, f. 14.

23 Dr. Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro - malazeze (1881 – 1914)*, Institut i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 109.

Gërdeçit, ku zhvilloheshin luftime kundër ushtrisë osmane²⁴. Në mars të vitit 1910, vali i Kosovës, Manxhar Pasha, vendosi në mënyrë arbitrare taksën e oktrovit, e cila nuk tatohej në asnjë vend të Perandorisë Osmane. Por fshatarët e Mitrovicës, Vushtrrisë, Llapit, Prishtinës etj, u ngritën kundër arbitraritetit të valit të Kosovës dhe revolta e tyre shërbeu si sinjal për fillimin e kryengritjes. Shqiptarët shprehën kërkesat për shkolla shqipe, për ndërtimin e rrugëve, për të mos paguar taksat e rënda që ishin vënë nga autoritetet e vendit etj. Në të njëjtën kohë shqiptarët e Pejës, u ngritën dhe vranë komandantin e forcave osmane, Rushit Beun dhe plagosën mytesarifin e Pejës Haki Beun²⁵. Në nahinë e Gjakovës kishte filluar veprimi i çetave të armatosura, ndërsa në kazanë e Pejës, pas atentatit që u bë kundër një oficeri turk, po bëheshin përgatitje të fshehta për aksionin e armatosur. Në fund të muajit mars në Sanxhakun e Prishtinës shpërthyen turbullirat në shenjë revolte kundër taksave të reja që vuri Qeveria osmane. Kështu, grupe të armatosura shqiptarësh të anës së Mitrovicës,²⁶ të Vushtrrisë dhe të Llapit u vunë në lëvizje dhe morën drejtimin e Prishtinës për të protestuar kundër caktimit arbitrar të taksës së re mbi prodhimet bujqësore të cilat nxirreshin në treg. Kësaj lëvizje të turmave popullore autoritet osmane iu përgjigjën me masa të rrepta ushtarake. Repartet e garnizonit të Prishtinës dolën jashtë qytetit për t'u prerë rrugën kryengritësve, dhe më 5 prill u ndeshën me forcat shqiptare në vendin Babin Most. Gjatë kësaj përlëshjeje, luftëtarët e Llapit, të mbështetur në forcat e tjera, arritën ta rrethojnë një batalion, vranë disa oficerë, zunë rob disa dhjetëra ushtarë, kështu që ushtria turke u detyrua të tërhiqej nga Prishtina me humbje të ndjeshme në njerëz dhe në armatime. Pas këtyre përlëshjeve të para, gjendja në këtë pjesë të Kosovës u bë edhe më e ndërlikuar, sepse trupat ushtarake të stacionuara në Prishtinë, Vushtri, Mitrovicë, Pejë, Prizren e Gjakovë ishin të pamjaftueshme për ta shtypur menjëherë kryengritjen²⁷. Mirëpo, fitorja e shkëlqyer e Babin Mosti u kishte dhënë në njëfarë mënyre ndihmesë forcave kryengritëse të Llapit dhe të Drenicës që t'i vazhdonin veprimet sipas objektivit kryesor, që ishte kryeqendra e sanxhakut-Prishtina²⁸. E shqetësuar nga këto ngjarje, qeveria xhonturke, në mbledhjen që mbajti më 7 prill, vendosi që të merreshin masa të rrepta ushtarake kundër kryengritësve. Përballë zhvillimit të shpejtë të ngjarjeve në rrethet e Prishtinës, të Pejës e të Prizrenit, qeveria xhonturke mori masa për të penguar zgjerimin e kryengritjes. Me dekretin perandorak të Sulltan Mehmet Rashitit V u shpall në zonën e kryengritjes

24 Dr. Shukri Rahimi. *Lufta e shqiptarëve për autonomi...*, f. 159.

25 Fatmira Musaj. *Isa Boletini... vep. e cit.*, f. 75.

26 Zekeria Cana. *vep. e cit.*, f. 100.

27 ASHKP. Fondi: Maringlen Verli. Dosja: Kujtimet e Isa Boletinit – Tafil Boletini.

28 Zekeria Cana. *vep. e cit.*, f. 101-102.

gjendja e jashtëzakonshme, urdhërohej të shpërndareshin sa më shpejt forcat kryengritëse, të arrestoheshin dhe të nxirreshin para gjykatës ushtarake organizatorët e kryengritjes, të bëhej regjistrimi i popullsisë dhe i pasurisë së patundshme, të zbatoheshin shërbimi i detyrueshëm ushtarak, të mblidheshin me forcë taksat etj. Porta e Lartë urdhëroi Ministrinë e Luftës që të përgatiste sa më shpejt ekspeditën ndëshkimore, në krye të së cilës do të vihej Shefqet Turgut pasha, njëri nga gjeneralët më të zotë të ushtrisë osmane. Për të përballuar ekspeditën e madhe ushtarake që Porta po përgatiste kundër Kosovës, u pa e nevojshme të merreshin masa organizative e ushtarake²⁹, të cilat do të vendoseshin në tubimet e udhëheqësve shqiptarë. Autoritetet xhonturke, me gjithë përpjekjet që bënë, nuk arritën ta pengonin mbledhjet lokale të udhëheqësve shqiptarë. Në kuvende si të Verrat e Lukës, Isniqit, Ferizajit etj., hodhën themelet e bashkimit luftarak të shumicës së krahinave të Vilajetit të Kosovës, kryesisht të pjesës perëndimore e qendrore³⁰. Sukseset e kryengritësve në Grykën e Carralevës dhe shtënia në dorë e Shkallës së Kaçanikut përbënin një fitore ushtarake të rëndësishme, e cila ndikoi në zhvillimin e mëtejshëm të kryengritjes në Kosovë. Më 10 maj, pas një lufte që zgjati gjithë ditën, kryengritësit, duke përfutur nga errësira e mbrëmjes, çanë rrethimin; gjatë tërheqjes mundën të marrin me vete shokët e plagosur, midis të cilëve edhe komandantin e tyre, Isa Boletinin, që u dallua në këto luftime si udhëheqës e komandant i aftë dhe i talentuar ushtarak³¹. Kështu, ekspedita e Xhavit Pashës, me djegie e vrasje në mënyrë që ta trembë popullin me dhunë e terror bëri kundër efekt në dëm të tyre e në favor të shqiptarëve, rezultati i së cilës u pa më 1910 në Kaçanik, Carralevës e në Llap³². Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, për një kohë të shkurtë ishte shndërruar në ngjarje me rëndësi, duke i dhënë kryengritjes karakter të një lufte të organizuar për çlirim e bashkim kombëtar³³. Forcat kryesore të kryengritësve veprimet e tyre i përqendruan në dy drejtime: grupi i përbërë nga luftëtarë të Shalës, të Llapit dhe të Drenicës, me në krye Isa Boletinin dhe prijës të tjerë, u drejtua kah jugperëndimi dhe doli në Grykën e Carralevës, me qëllim që t'i shtinte në dorë të gjitha shtigjet dhe në këtë mënyrë t'ia bënte ushtrisë osmane të pamundur depërtimin në vijën Ferizaj-Shtime-Prizren³⁴. Grykën e Carralevës e mbronin me sukses tre mijë luftëtarë të udhëhequr nga Isa Boletini, ndërsa forcat e tjera, që kishin zënë pozitat në shpatet mbi Carralevës dhe në fshatrat Ribar, Godanc dhe Zborc, u mbronin mbrojtësve

29 *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 427.

30 Po aty, f. 428.

31 *Po aty*, f. 430-433.

32 ASHKP, Fondi: Maringlen Verli, Dosja: Kujtimet e Isa Boletinit – Tafil Boletini.

33 Dr. Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi...*, f. 170.

34 Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare shqiptare...*, f.107.

të Carralevës shpatullat³⁵. Konflikti midis Komitetit xhonturk dhe shqiptarëve ishte ashpërsuar edhe më shumë. Në betejën për mbrojtjen e Grykës së Carralevës e cila zgjati prej 14 prillit e deri më 27 prill 1910³⁶, shohim aftësitë e Isa Boletinit dhe si komandant ushtarak popullor. Për zhvillimin e drejtimin e veprimeve luftarake ai hartoi dhe zbatoi një taktikë të zhdërvjelltë dhe vepruese duke manovruar me shpejtësi, zgjuarsi në rrethana të krijuara. Ashtu si kryengritësit e Kaçanikut dhe mbrojtësit e Carralevës shfrytëzuan terrenin e favorshëm dhe taktikën e luftës popullore duke detyruar forcat osmane të tërhiqeshin disa herë me humbje të shumta njerëzore dhe armatime³⁷. Me kundërshtimin e deputetëve shqiptarë në parlamentin turk për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe për të penguar dërgimin e forcave ushtarake kundër kryengritësve, Qeveria osmane kishte vendosur që ta shtyp kryengritjen me forcën e armëve³⁸. Meqenëse Kryengritja e vitit 1910, përfundoi pa arritur objektivat kryesore, ajo pati një jehonë të jashtëzakonshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo kryengritje ishte kryengritja më e organizuar në hapësirat kombëtare shqiptare³⁹, e cila ndikoi në organizimin e Kryengritjes së vitit 1911 dhe Kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. Kryengritja e Kosovës e vitit 1910 ishte e para lëvizje e armatosur e popullit shqiptar në fillim të shek. XX, por që mbeti në kufijtë e një vilajeti të vetëm. Kryengritësit edhe pse luftuan për të përballuar marshimin e ushtrisë së komanduar nga Shefqet Turgut pasha, nuk arritën të organizonin një kryengritje të përgjithshme në gjithë vilajetin. Disa vatra të qëndresës së shqiptarëve, siç qenë ato të Kaçanikut, Carraleva etj., mbetën të shkëputura nga njëra-tjetra. Kryengritja e Kosovës u shtyp për shkak se shqiptarët u ndodhën përballë një ushtrie e cila posedonte numër të madh në armatime e në pajisje luftarake dhe e drejtuar nga oficerë të zgjedhur, të stërvitur nga instruktorë të huaj⁴⁰.

Isa Boletini si një nga udhëheqësit kryesorë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në Lëvizjet kryengritëse 1908-1910 pati rol të pazëvendësueshëm në të gjitha organizimet dhe përpjekjet e popullit shqiptar sidomos në Vilajetin e Kosovës. Ai përveç të qenurit autoritet e tribun popullor, gradualisht u shndërrua në një nga figurat qendrore të lëvizjes Kombëtare Shqiptare në përgjithësi.

35 Zekeria Cana, *vep. e cit.*, f.121.

36 Dr. Shaban Hashani, *Isa Boletini dhe Rezistenca shqiptare kundër pushtuesve turq në Ferizaj dhe rrethimë më 1908-1910*, në *Isa Boletini dhe koha e tij*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 1998, f. 71.

37 Prof. Dr. Fatmira Musaj, *Kontributi i Isa Boletinit në organizimin...*, 2012, f. 103.

38 Po aty, f. 101.

39 Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, *Kryengritja antiosmane...*, f. 19.

40 *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 439.

Isa Boletini u njoh dhe u trajtua si personalitet dhe partner i mundshëm edhe i qarqeve diplomatike, posaçërisht atyre të Fuqive të Mëdha si Austro-Hungaria, Italia etj., të cilat kishin interesa të drejtpërdrejta apo të tërthorta jo vetëm sa i takon çështjes shqiptare por edhe asaj ballkanike dhe më gjerë. Isa Boletinin u munduan ta “bënin për vete” edhe Perandoria Osmane, Mali i Zi dhe Serbia por ai ishte dhe mbeti personalitet i qëndrueshëm dhe stoik përballë sfidave dhe tundimeve duke lënë mënjatë gjithçka dhe duke u përkushtuar i tëri për liri e shtet kombëtar.

Ardita HAJDARI

SUMMARY

THE ROLE OF ISA BOLETINI IN UPRISING OF 1910 IN KOSOVA

Isa Boletini as one of the main leaders of the Albanian National Movement and the key player in the uprising of 1910-1912 in Kosova, he fought for unification of Albanian forces against the Ottoman invaders. Isa Boletini's activity has been depicted by many authors and scholars national and international who still continue to explore his personality from various perspectives. Isa was born on January 15, 1864 in village Boletin of Shala e Bajgorës, in a prominent family which excelled for patriotic tradition in the area of Mitrovica and the Vilayet of Kosova. Isa Boletini lived and acted in the times of hardship which made him one of the most renowned personalities of our nation. Isa was among the very first leaders of the Albanian national movement who had come out against the anti-Albanian politics of the Young Turks. It was the time of great efforts and Renaissance of our people in general struggling national liberation and unification. He contributed comprehensively to the liberation of Albanian lands and foundation of the national state.

The announcement of Huriyet in 1908. Turkish government had taken a series of measures and restrictive laws against the Albanian people in order to realize its objectives, thus trying to deny the existence of Albanian people in any manner. The program included: ban on gun ownership, the law on general recruitment, enforcement of new taxes, the law banning national clubbing activities, ban of national alphabet and language. All these measures led to the deterioration of contradictions with Albanian people and caused mass dissatisfaction in different provinces. Tax load of the rural population made their survival painful at every step. With these factors and circumstances under the new regime taking place, Kosova sustained to be the center for national liberation and emancipation movements. Uprising of 1910 in Kosova, in short period of time shaped important events, giving it a character of organized struggle for national liberation and unification.

Although, the uprising of 1910 failed without reaching its objectives, it had exceptionally echoed internal and international opinion. This well-organized uprising led to continuation of another in 1911 and to the General Uprising of 1912. The murder of Isa Boletini organized by Ministry of War of the Kingdom of Montenegro has been conducted in an ambush on January 26, 1916. Boletini, two of his sons, two nephews and three men of his were killed deceitfully.